



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. 1238/5 Prot.

Tiranë, më 14 / 11 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 166 , Datë 14 / 11 / 2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.99 Regjistri, datë 15.08.2019, të subjektit ankues, L. Dh, kundër Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, L. Dh, ka informuar Komisionerin lidhur me problematikën e saj, e cila konsiston si më poshtë citohet:

---

<sup>1</sup>Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Referuar njoftimit të bërë në faqen e APP nr.48, datë 03.12.2018, për një vend pune në pozicionin e lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ankuesja ka paraqitur aplikimin e saj.

Ankuesja shprehet se dosja e saj është skualifikuar pa asnjë shkak të ligjshëm nga ana e Komisionit të Vlerësimit. L.Dh pretendon se shkak i skualifikimit të saj ka qenë mospërmbushja e një kriteri, i cili në fakt nuk është fare në listën e kriterëve që duhet të përmbushin kandidatët.

Lidhur me këtë fakt, ajo është ankuar si pranë Universitetit të Shkodrës, ashtu dhe pranë Ministrisë së Arsimit, Sporti dhe Rinisë (MASR). Për të verifikuar situatën e ankueses, MASR ka ngritur një grup inspektimi, i cili në përfundim ka konstatuar shkelje dhe parregullsi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve dhe i ka rekomanduar Universitetit të Shkodrës ripërsëritjen e konkursit. Rekomandimi i MASR nuk është zbatuar nga ana e Universitetit të Shkodrës duke e përjashtuar ankuesen nga konkurimi.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të saj, për shkakun e pretenduar, nga ana e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH) dhe anulimin e konkursit të zhvilluar nga ana e Universitetit.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të

---

<sup>2</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

*njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1238/2 prot., datë 23.08.2019, Komisioneri i ka kërkuar informacion Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH), lidhur me pretendimin e L. Dh.

Nëpërmjet shkresës me nr.2813/1 prot., datë 04.09.2019, USH ka dërguar bashkëlidhur dokumentacionin kërkuar nga Komisioneri, pa paraqitur parashtrime specifike. Dokumentacioni i dërguar nga USH është marrë në konsideratë nga Komisioneri në kontekst të vlerësimit të fakteve dhe provave të çështjes, në funksion të vendimmarrjes së tij.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë të pretenduar nga subjekti ankues.**

Referuar njoftimit të bërë në faqen e APP nr.48, datë 03.12.2018, për një vend pune në pozicionin e lektorese brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ankuesja ka paraqitur aplikimin e saj.

Njoftimi ka të specifikuar kërkesat që kandidatët duhet të plotësojnë për këtë pozicion pune, në kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta. Kështu, në mënyrë të detajuar janë përcaktuar:

a) Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati:

- Të ketë zotësi të plotë veprimi, aftësi të punës në grup, aftësi komunikimi profesional.
- Të mos jetë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
- Të mos ketë marrë masë disiplinore të largimit nga puna.
- Të mos jetë larguar nga USH pa miratimin e këtij të fundit.
- Të mos ketë prishur në mënyrë publike imazhin e USH.
- Të mos ketë lidhje familjare (bashkëshort/bashkëjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër, vëlla dhe fëmijët e tyre, emtë a ungj) apo krushqie (prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjes ekzistues brenda të njëjtës njësi bazë apo ndihmëse ku kërkojnë të punësohen.

b) Kriteret e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të ketë kryer të gjitha ciklet e shkollimit me kohë të plotë në specialitetin “Biologji” ose “Biologji-Kimi”.
- Të ketë kryer ciklin e parë të studimeve në sistemin me kohë të plotë në degën “Biologji” ose “Biologji-Kimi”, me notë mesatare mbi 9.
- Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, me diplomë “Master i Shkencave” me drejtim Biologji, me notë mesatare mbi 9.
- Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, me diplomë “Master i Shkencave” ose “DIND” (300 kredite) në profilin “Biologji” ose “Biologji-Kimi”, me notë mesatare jo më të ulët se 9.
- Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga MASR.
- Të ketë notën mesatare të lëndëve për të cilat konkuron, mbi 9.
- Të ketë titull akademik apo gradë shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”.
- Të ketë të mbrojtur një nga gjuhët e huaja të BE-së, me notë jo më të ulët se 8 ose të ketë mbrojtur një nga pesë gjuhët e njohura nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1.

Dosja e kandidates L. Dh është skualifikuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit, Komision Ad-Hoc, i ngritur për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin e shpallur. Ankuesja ka ankimuar këtë fakt pranë USH dhe Rektori i USH –së, me Urdhrin nr.484, datë 31.12.2018 ka ngritur Komisioni Ad-Hoc për shqyrtimin e ankesës së L.Dh.

Nga këqyrja dhe verifikimi i dokumentacionit në dosje, konstatohet se USH, në përgjigje të kërkesave të subjektit ankues lidhur me shkakun e skualifikimit, ka mbajtur qëndrime të ndryshme dhe jo koherente. Kështu:

- Nëpërmjet shkresës me nr.333 prot., datë 29.01.2019, USH informon ankuesen, ndër të tjera se, arsyeja e skualifikimit të saj<sup>3</sup>qëndron në faktin se diploma e nivelit të dytë, e paraqitur prej saj, me nr.regjistri 361, datë 23.03.2009, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, e ka mesataren 8.42, duke mos u përputhur me kriterin e kërkuar (jo më pak se 9). Por, edhe pas mbledhjes së mesatareve të diplomave të paraqitura, diplomës sipërcituar dhe asaj të sistemit 4 vjeçar me nr.1008, datë 15.07.2005, me mesatare 9.36, rezulton që mesatarja është 8.89. Po ashtu, ankueses i është bërë me dije se është skualifikuar për mosplotësim të kriterëve specifike të përcaktuara nga Departamenti, sipas të cilit kandidati preferohet të ketë specialitetin “Botanikë”.
- Nëpërmjet shkresës me nr.650/4 prot., datë 25.03.2019, USH ka evidentuar faktin se, kandidatja e skualifikuar (ankuesja) me atë fituese, plotësonin të gjitha kriteret e vendosura nga njësia bazë dhe të miratuara nga Rektori për konkurs, por ajo që bën diferencën mes kandidatës fituese dhe asaj jo fituese janë pikërisht kriteret preferenciale të vendosura nga njësia bazë, pra punimi i doktoraturës, shkon në përshtatje me nevojat e departamentit Biologji-Kimi *ku preferohej* “Botanika”. Ndërsa, përsa i përket kriterit të mesatares, kanë theksuar faktin se të dyja kandidatet plotësonin në përputhje të plotë me prashikimet ligjore të nenit 124, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, por, përsa kohë Komisioni duhet të përcaktonte vetëm një fituese, mori në konsideratë edhe mesataren e diplomave të studimeve, duke vlerësuar më mirë studenten me mesataren më të lartë, pasi, të dyja kandidatet zotëronin diplomë 4 vjeçare në degën Biologji-Kimi (pra, ishin në kushte të barabarta) dhe të dyja kandidatet zotëronin master shkencor, si dhe të dyja kishin përfunduar studimet duke marrë titullin "Doktor".
- Ndërkaq, nëpërmjet shkresës me nr.1748/4 prot., datë 21.06.2019, USH informon ankuesen se kandidatura e saj është skualifikuar nga ana e Komisionit Ad-Hoc vetëm për kriteret preferenciale të vendosura nga njësia bazë, pra punimi i doktoraturës duhet të ishte në përshtatje me nevojat e Departamenti Biologji-Kimi, ku preferohej Botanika.

---

<sup>3</sup> Pika 4, e faqes 2, të kësaj shkrese.

Lidhur me sa mësipër, në kontekst të përmbushjes dhe plotësimit të kriterëve të përcaktuara, Komisioneri konstaton se:

- Lidhur me kriterin e veçantë, preferencial:

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 64, pikën 1 të tij, ka parashikuar se: *“Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë drejtohet nga një komision Ad-Hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit Ad-Hoc, si dhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në statutin e IAL-së”*.

Në zbatim të sa mësipër, Departamenti i Biologji-Kimisë ka vlerësuar vendosjen e kriterëve, të ndara konkretisht në kriterë specifike dhe në kriterë të përgjithshme. Subjekti ankues është skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve specifike, *preferenciale*, dhe konkretisht:

*Së pari*, lidhur me kriterin e përcaktuar si kriter preferencial, të shpallur në njoftimin për këtë pozicion pune, që aplikanti duhet: *“Të ketë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”*”, Komisioneri vlerëson se, mbajtja e gradës shkencore “Doktor” në “Biologji molekulare” nga ana e aplikantit, edhe nëse aplikanti nuk ka aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”, duhet të mbahej në konsideratë nga ana e Komisionit të Vlerësimit dhe nuk mund të shërbente si kriter skualifikues dhe përjashtues, përse kohë ai plotëson kushtin parësor, i cili duhet të prevalojë mbi “preferencën” e kërkuar.

Në kushtet kur, nga ana e USH është vendosur që ky kriter, pra drejtimi në “Botanikë” të jetë preferencial, **atëherë ky kriter duhet të shërbente si kriter vlerësues dhe për rrjedhojë mund të ndryshonte nivelin e pikëzimit, vlerësimit, por nuk duhet të çonte në skualifikimin e kandidatës.**

*Së dyti*, në njoftimin për shpalljen e konkursit për vend të lirë pune, në pozicionin Lektor/e me kohë të plotë, në Departamentin e Biologji-Kimisë, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, nuk rezulton të jetë përcaktuar grup lëndë për të cilën kërkohet të angazhohet personeli akademik. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri vlerëson se, **mospërcaktimi i fushës/grup lëndëve për personelin akademik që do të angazhohet me kohë të plotë, sjell pabarazi në vlerësimin e aplikantëve/kandidatëve, referuar këtij kriteri preferencial.**

Së treti, në njoftimin sipërcituar, USH ka listuar si kriter përjashtues që aplikanti duhet: *“Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë me diplomë “Master i shkencave” ose “DIND” (300 kredite) në profilin “Biologji” ose “Biologji-Kimi” me notë mesatare jo më të ulët se 9”*.

Lidhur me plotësimin e këtij kriteri nga ana e subjektit ankues, Komisioneri konstaton se, ankuesja, bazuar në dokumentacionin e depozituar në dosje, rezulton të jetë diplomuar në degën “Biologji-Kimi” në vitet akademike 2001-2005, diplomë 4-vjeçare, sipas sistemit të mëparshëm, të kohës kur është diplomuar.

Neni 124, pika 2 e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar se: *“Diplomat e programeve të studimit, të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, që kanë zgjatur, së paku 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve, sipas parimeve të procesit të Bolonjës, janë ekuivalente me diplomat “Master i Shkencave”*. Ky Ligj ka përcaktuar fushat dhe programet e studimit të cilat ofrojnë programe të integruara të nivelit të dytë.

Pra, në interpretim të sa mësipër, diploma e L. Dh është ekuivalente me diplomën e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, gjë që bën që ajo të përmbushë kriterin e përcaktuar nga Departamenti i Biologji-Kimisë, sa i takon kërkesës për diplomë të nivelit të dytë “Master i shkencave”.

Së katërti, lidhur me argumentimin e USH për skualifikimin e kandidates, L. Dh për shkak se përveç sa më sipër kemi cituar, ajo nuk përmbush kriterin e mesatares mbi 9, për një cikël studimesh me 300 kredite, evidentohet se kjo mesatare është përlllogaritur duke mbledhur mesataren e ciklit të studimeve “Master i Shkencave” dhe të ciklit të studimit “Master Ekzekutiv<sup>4</sup>”, të cilën e disponon ankuesja.

Lidhur me argumentin e përdorur nga USH<sup>5</sup> se ankuesja nuk plotësonte kriterin specifik, sipas të cilit kandidati duhet *“të ketë mbaruar domosdoshmërisht studimet master i nivelit të dytë në fushën përkatëse me notë mesatare jo më të ulët se 9”*, Komisioneri, vlerëson se:

- Një përcaktim i tillë nuk rezulton të jetë listuar në njoftimin e bërë nga USH për pozicionin e shpallur vakant.
- Nga ana tjetër, ky argument është i pabazuar ligjërisht, pasi referuar kriterit specifik të kërkuar : *“Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, me diplomë “Master i Shkencave” ose “DIND” (300 kredite) në profilin “Biologji” ose “Biologji-Kimi”, me notë mesatare jo më të ulët se 9”*, ankuesja ka provuar se plotëson njërin prej kushteve, atë të posedimit të diplomës “Master i shkencave”, me mesatare mbi 9, dhe për rrjedhojë nuk mund të skualifikohej për një kriter tjetër i cili është opsional.

<sup>4</sup> Referuar nga USH si master i nivelit të dytë.

<sup>5</sup> Referuar shkresës me nr.89 prot., datë 27.12.2018.

Nga ana e USH, vërehet përdorimi i lidhëzës “ose” referuar të njëjtit kriter përjashtues, në përzgjedhjen e kandidatëve. Pra, kushtet e vendosura brenda së njëjtës fjali, nuk janë kumulative, gjë që passjell që dhe plotësimi i vetëm njëres prej tyre, të konsiderohet se ndodhemi përpara përmbushjes së këtij kriteri në tërësinë e tij<sup>6</sup>.

**Në kontekst të analizimit të gjithë fakteve sipër përmendur, veçmas dhe bashkarisht, Komisioneri vlerëson se, ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë në raport me kandidaten e shpallur fituese, pikërisht përse i takon vlerësimit të gabuar që Komisioni i Vlerësimit i ka bërë L.Dh bazuar në kriterin specifik preferencial të vendosur nga Departamenti i Bilogji-Kimisë, duke e vlerësuar si përjashtues.**

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, subjekti ankues, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, krahasuar me kandidaturën e znj.A. K, nga ana e USH-së.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>7</sup>, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

<sup>6</sup> Konkluzion i dalë dhe nga MASR, në rekomandimet që I ka bërë USH lidhur me rastin e L. Dh.

<sup>7</sup> *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”*



Ankuesja ka pretenduar në thelb, trajtim të padrejtë, nga ana e Komisionit të Vlerësimit, bazuar në vlerësimin e gabuar të kriterit preferencial.

Gjatë parashtrimeve të saj, ankuesja ka pretenduar dhe diskriminim “për çdo shkak tjetër”, duke argumentuar se vlerësimi i gabuar i kriterit preferencial ka bërë që ajo të jetë diskriminuar nga ana e USH përmes skualifikimit të saj.

**Komisioneri konstaton se ajo në vetvehte e gëzon kualifikimin e duhur për pozicionin e shpallur. Skualifikimi që Komisioni i Vlerësimit, i bën ankueses dhe gjithë kategorisë së aplikantëve konkretë apo qoftë dhe potencial, të cilët gëzojnë titullin “Doktor” në fushën e Biologjisë por jo domosdoshmërisht me orientim në “Botanikë”, bën që vlerësimi i tyre të jetë paragjykes që në fillim duke u hequr të drejtën dhe mundësinë kësaj kategorie, që t’i nënshtrohen një procesi të rregullt dhe drejt vlerësimi.**

**Përkatësinë e ankueses dhe të gjithë kategorisë së aplikantëve konkretë apo qoftë dhe potencial, të cilët gëzojnë titullin “Doktor” në fushën e Biologjisë por jo domosdoshmërisht me orientim në “Botanikë”, Komisioneri e vlerëson si shkak të mbrojtur të LMD-së, referuar si “përkatësi në një grup të veçantë”.**

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9<sup>8</sup> të tij “Ndalimi i diskriminimit”, parashikon “përkatësinë në një grup të veçantë” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

---

<sup>8</sup> Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.

### C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

“Çdo shkak tjetër<sup>9</sup>” përbën shkak, për të cilin Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesja mbart shkakun e mbrojtur.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesja është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, krahasuar me kandidaturën e znj.A. K, nga ana e USH-së.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive

---

<sup>9</sup> Në kontekst të analizës së bërë në faqen 10 të këtij Vendimi.

themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>10</sup>

Karta Social Europiane<sup>11</sup> parashikon si detyrim të të gjithë vendeve nënshkruese përmbushjen dhe zbatimin e disa parimeve. Në pjesën e parë të kësaj Karte parashikohet: *“Palët pranojnë si synim të politikës së tyre, që do të ndiqet me të gjitha mjetet e përshtatshme, si të karakterit kombëtar, ashtu edhe ndërkombëtar, arritjen e kushteve në të cilat të drejtat dhe parimet e mëposhtme mund të realizohen në mënyrë efektive: Cilido do të ketë mundësinë të fitojë jetesën e tij në një punë në të cilën ka hyrë lirisht.”*

Në vijim, në nenin 1 të Kartës sanksionohet e drejta për punë dhe në nenin E), Pjesa V, të Kartës Social Europiane parashikohet shprehimisht: *“Gëzimi i të drejtave të parashikuara në këtë Karte do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkaku të tillë si racë, ngjyrë, seks, gjuhë, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjine shoqërore, shëndeti, shoqërimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër”*.

Mbrojtjen e parimit të mosdiskriminimit në marrëdhëniet e punës e gjejmë të parashikuar edhe në Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për *“Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, ku në interpretim të zgjeruar të saj, ndër të tjera përfshihet edhe mbrojtja nga diskriminimi për shkakun e sipërcituar<sup>12</sup>.

Duke vijuar më tej, legjislacioni shqiptar e ka përforcuar mbrojtjen nga diskriminimi edhe nëpërmjet parashikimeve me karakter antidiskriminues në akte të tjera, ligjore. Neni 9, i Kodit të Punës<sup>13</sup>, parashikon se: *“Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo*

<sup>10</sup> [https://ëëë.echr.coe.int/Documents/Handbook\\_non\\_discrim\\_laë\\_SQL.pdf](https://ëëë.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_laë_SQL.pdf), faqet 47 dhe 49

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin Nr. 8960, date 24.10.2002.

<sup>12</sup> Fq 8-9 e vendimit.

<sup>13</sup> Përafruar pjesërisht me:

*Direktivën e Këshillit 91/533/KEE, datë 14 tetor 1991, “Mbi detyrimin e punëdhënësit për të informuar punonjësit për kushtet e zbatueshme në kontratë ose në marrëdhënien e punësimin” . Numri CELEX 31991L0533, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 288, dt. 18. 10. 1991, f. 32 – 35.*

*formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me Hiv/Aids, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët.”*

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së. Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim.

Ligji nr. 10 221/2010 “Per Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germat a), b), parashikon se: “*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve”.*

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar në lidhje me procedurat e punësimit për personelin mësimor, vërehet se duke analizuar procedurën e ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për një vend pune në pozicionin e lektorese brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, rezultoi se në bazë të tij, përjashtohen nga konkurrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët<sup>14</sup>, përfshirë edhe ankuesen, që kanë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, por që nuk kanë aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”, duke bërë paragjykes që në fillim gjithë procesin. Ky veprim krijon dyshimin e arsyeshëm që kandidati fitues është paracaktuar nga ana e këtij Komisioni.

---

*Direktivën e Këshillit 2000/78/KE, datë 27 nëntor 2000, “Mbi krijimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe profesion”. Numri CELEX 32000L0078, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 303, dt. 2. 12. 2000, f. 16-22.*

*Direktivën 2006/54/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 5 korrik 2006, “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit”. Numri CELEX 32006L0054, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 204, dt. 26. 7. 2006, f. 23-36.*

<sup>14</sup> Kandidatët që kanë konkuruar, po ashtu edhe ata që “hipotetikiisht” mund të kishin konkuruar.

**Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, nga ana e USH është vendosur që ky kriter, pra drejtimi në “Botanikë” të jetë preferencial, atëherë ky kriter duhet të shërbente si kriter vlerësues dhe për rrjedhojë mund të ndryshonte nivelin e pikëzimit, vlerësimit, por nuk duhet të çonte në skualifikimin e kandidatës. Skualifikimi i menjëhershëm duke mos vlerësuar dosjen e ankueses, për rrjedhojë, mos përfshirja e saj në pikëzimin e kandidatëve, ka cenuar të drejtën e ankueses për një konkurs të ndershëm e të drejtë nga ana e USH.**

Komisioneri vlerëson se kriteret dhe kualifikimet e kandidatëve duhet të jenë të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve dhe se vendosja e kufizimeve për kandidatët duhet bërë vetëm në rastet kur është absolutisht e nevojshme mbrojtja në veçanti e interesave të rëndësishme të palëve të interesuara dhe duhet që në të gjitha rastet, masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cënimin më të vogël të mundshëm, me qëllim që të sigurohet të gjithë të interesuarve e drejta për të zgjedhur profesionin dhe për të siguruar mjetet e jetesës nëpërmjet punësimit.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3, pika 3, parashikon se: “Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

**Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kandidatja dhe të gjithë kandidatët në kushte të njëjta me ankuesen, diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vlerësimi që Komisioni i bën kriterit preferencial, sipas të cilit kandidati i cili duhet të ketë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”, duke sjellë skualifikimin e tyre që në fillim.**

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të Kodit të Punës nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## VENDOSI:

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të L. Dh dhe të gjithë kandidatëve në kushte të njëjta me të, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, përmes vlerësimit të gabuar nga ana e Komisionit të kriterit preferencial, sipas të cilit kandidati i cili duhet të ketë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”.
2. Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me skualifikimin e kandidates L. Dh, në konkursin për pozicionin e lektores së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë pranë këtij universiteti, duke përsëritur rishtaz procedurën e punësimit në funksion të gjetjeve të konstatuara në këtë vendim.
3. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
4. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë, gjendja arsimore, çdo shkak tjetër